

Nr. Ref: 13/ZDP/VE/2025
01.07.2025

Në mbështetje të neneve 2, 14, 36 të Ligji Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 dhe 25 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksinin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe Rregullores (AAC) nr. 08/2024 për lëshimin e aprovimeve për fluturime të mjeteve ajrore civile,

Duke vepruar sipas kërkesës së Komisionit Rregullator të Aviacionit Civil të Jordanisë (CARC) të pranuar në AAC më dt. 26 qershor 2025,

Drejtoari i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil (më tutje "AAC") nxjerr l.ëtë:

VENDIM

1. Lejohet, për periudhën e caktuar, zhvillimi i veprimtarisë së transportit ajror për fluturimet me orar të caktuar dhe pa orar të caktuar të pasagjerëve, ngarkesave dhe/ose postës, për dhe nga Kosova në Jordani, për operatorët ajrorë që posedojnë Certifikatën e Operatorit Ajror (COA) të Mbretërisë Hashemite të Jordanisë.
2. Operatorët ajrorë nga pikë 1 të këtij Vendimi, gjatë ofrimit të shërbimeve, janë të detyruar të respektojnë me përpikëri të gjitha dispozitat rregullatore dhe aktet normative në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është i vlefshëm deri më 25 tetor 2025.

Arsyetim


Me datë 29 qershor 2025, Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës ka pranuar kërkesë nga Komisioni Rregullator i Aviacionit Civil të Jordanisë (CARC) për miratimin e operimit të fluturimeve me orar të caktuar dhe pa orar të caktuar nga transportuesit ajrorë kombëtarë të Jordanisë, nga Jordania drejt Kosovës dhe anasjelltas.

Në këtë kërkesë, CARC shpreh interesimin e transportuesve ajrorë të Jordanisë për zhvillimin e këtyre fluturimeve, duke theksuar gjithashtu se kërkesat e transportuesve kosovarë për operate të ngjashme do të trajtohen në mënyrë reciproke dhe të barabartë.

Në këtë shkresë, CARC propozon që autoritetet aeronautike të të dy vendeve të fillojnë negociatat gjatë vitit 2025 për finalizimin e një Marrëveshjeje Bilaterale të Shërbimeve Ajrore midis Jordanisë dhe Kosovës.

Duke marrë parasysh këtë nismë dhe kërkesën e CARC për miratimin e përkohshëm të operimit të fluturimeve pa orar të caktuar deri në finalizimin e marrëveshjes, si dhe interesin e kompanive ajrore jordaneze për të zhvilluar këto fluturime në periudhën nga qershori deri në tetor të vitit 2025, Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, në përputhje me nenet 2, 14, dhe 36 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063, si dhe nenin 24 dhe 25 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Rregulloren (AAC) nr. 08/2024 për lëshimin e aprovimeve për fluturime të mjeteve ajrore civile ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Matej Krasniqi
UD. Drejtor i Përgjithshëm



Vendimi i dërgohet:

- Ministrit të MMPHI;
- Arkivit të AAC-së.